




**RAPORTI I MBIKËQYRJES** | **2021**  
***SUPERVISION REPORT***

TREGU I SIGURIMEVE, I FONDEVE TË PENSIONEVE VULLNETARE, I FONDEVE TË INVESTIMEVE  
*INSURANCE, VOLUNTARY PENSIONS FUNDS, INVESTMENTS FUNDS MARKET*

## PËRMBAJTJA


<b>I.</b>	<b>Misioni i Mbikëqyrjes</b>	<b>5</b>
<b>II.</b>	<b>Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Sigurimeve</b>	<b>6</b>
	1. Struktura e Tregut të Sigurimeve	6
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve	6
	3. Analiza e Ecurisë dhe Rreziqeve të Tregut të Sigurimeve	10
<b>III.</b>	<b>Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Pensioneve Private Vullnetare</b>	<b>12</b>
	1. Struktura e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	12
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare	14
	3. Treguesit Teknikë e Financiarë të Tregut të Fondeve të Pensioneve Vullnetare	14
<b>IV.</b>	<b>Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Fondeve të Investimeve</b>	<b>14</b>
	1. Struktura e Tregut të Fondeve të Investimeve	14
	2. Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Investimeve	15
	3. Treguesit Kryesorë të Tregut të Fondeve të Investimeve	16
<b>V.</b>	<b>Tregu i Kapitaleve</b>	<b>17</b>
	1. Tregu i obligacioneve të shoqërive aksionare (Obligacionet e emetuara me ofertë private)	17
	2. Tregu i rregulluar	18
	3. Mbikëqyrja e tregut të kapitaleve	19
	4. Zhvillime në përmirësimin e infrastrukturës së tregut	19
<b>VI.</b>	<b>Aneksë</b>	<b>21</b>
	A. Tregu i Sigurimeve, 31.12.2021	21
	B. Tregu i fondeve të pensioneve private vullnetare, 31.12.2021	83
	C. Tregu i Fondeve të Investimeve, 31.12.2021	91
	D. Shoqëritë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive	118



## TABLE OF CONTENTS

<b>I.</b>	<b><i>Supervision Mission</i></b>	<b>5</b>
<b>II.</b>	<b><i>Report on the Financial Position of the Insurance Market</i></b>	<b>6</b>
	1. <i>Insurance Market Structure</i>	6
	2. <i>Insurance Market Supervision</i>	6
	3. <i>Analysis of Insurance Market Performance and Risks</i>	10
<b>III.</b>	<b><i>Report on the Financial Position of the Voluntary Private Pension Market</i></b>	<b>12</b>
	1. <i>Voluntary Private Pensions Market Structure</i>	12
	2. <i>Voluntary Private Pension Market Supervision</i>	14
	3. <i>Technical and Financial Indicators on the Voluntary Pension Funds</i>	14
<b>IV.</b>	<b><i>Report on the Financial Position of the Investment Fund Market</i></b>	<b>14</b>
	1. <i>Investment Funds Market Structure</i>	14
	2. <i>Investment Funds Market Supervision</i>	15
	3. <i>Key Indicators of the Investment Funds Market</i>	16
<b>V.</b>	<b><i>Capital Market</i></b>	<b>17</b>
	1. <i>Corporate Bonds Market (Bonds Issued via Private Placements)</i>	17
	2. <i>Regulated Market</i>	18
	3. <i>Capital Market Supervision</i>	19
	4. <i>Market Infrastructure Improvements</i>	19
<b>VI.</b>	<b><i>Annexes</i></b>	<b>21</b>
	A. <i>Insurance Market, 31.12.2021</i>	21
	B. <i>Voluntary Private Pension Funds Market, 31.12.2021</i>	83
	C. <i>Investment Funds Market, 31.12.2021</i>	91
	D. <i>Pension Funds' and Collective Investment Undertakings' Management Companies</i>	118





## I. Misioni i Mbikëqyrjes

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është autoritet mbikëqyrës dhe rregullator i integruar i tregut financiar të sigurimeve, të titujve dhe të pensioneve private vullnetare në Shqipëri. AMF i ushtron funksionet mbikëqyrëse mbështetur në Ligjin nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar me Ligjin nr. 54/2014.

Misioni themelor i AMF-së, si autoritet mbikëqyrës është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, e lidhur ngushtë me sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur duke garantuar përmbushjen e dispozitave ligjore në fuqi.

AMF do të vijojë realizimin e misionin mbikëqyrës, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe direktivat evropiane, bashkërendimit të analizës së dokumentacionit financiar dhe mbikëqyrjes në vend të tregut, orientimit të procesit të mbikëqyrjes drejt mbikëqyrjes me fokus rreziku, ndërmarrjes së politikave zhvilluese për tregun, si edhe trajnimit të burimeve njerëzore drejt një mbikëqyrjeje efektive.

## I. Supervision Mission

*The Financial Supervisory Authority (AFSA) is the supervisory authority and integrated regulator of the financial insurance market, securities and voluntary private pensions in Albania. AFSA conducts its supervisory functions pursuant to Law No. 9572, dated 03.07.2006, “On Financial Supervisory Authority”, as amended by Law No. 54/2014.*

*AFSA’s basic mission, as a supervisory authority, is to protect consumers’ and investors’ interests, closely linked to the safety of supervised operators, by ensuring compliance with applicable legal provisions.*

*AFSA shall continue carrying out its supervisory mission through continuous improvement of the supervisory regulatory framework, in accordance with international principles and European directives, coordination of financial documentation analysis and on-site market supervision, orientation of the supervisory process towards a risk-based supervision, undertaking of the market development policies, as well as training of human resources towards an effective supervision.*

## II. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Sigurimeve

### 1. Struktura e tregut të sigurimeve

Gjatë vitit 2021 në tregun e sigurimeve ushtruan veprimtarinë e tyre 12 shoqëri sigurimi Jetë dhe Jo-Jetë. Në strukturën e tregut, tetë shoqëri sigurimesh ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e Jo-Jetës dhe katër në sigurimet e Jetës. Një nga shoqëritë e Jo-Jetës është gjithashtu e licencuar për të ushtruar edhe aktivitetin e risigurimit. Duke ruajtur të njëjtën tendencë si në vitet e kaluara, bazuar në pasqyrën e llogarisë teknike të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, edhe gjatë vitit 2021 vihet re se tregu i sigurimeve vazhdon të dominohet nga produktet e sigurimeve të detyrueshme dhe në veçanti nga portofoli i MTPL-së së brendshme.

### 2. Mbikëqyrja e tregut të sigurimeve

Në tërësi, edhe pse në një vit të vështirë për shkak të ndikimeve të pandemisë, tregu i sigurimeve u paraqit i qëndrueshëm në terma të treguesve kryesorë të shëndetit financiar, duke i rezistuar efekteve të pandemisë, me tregues të mirë likuiditeti, të aftësisë paguese si edhe të mbulimit me provigjone teknike.

Bordi Autoritetit, për shkak të kohëzgjatjes së pandemisë Covid-19, me qëllim ruajtjen e nivelit të likuiditetit dhe treguesve financiarë të shoqërive të sigurimit, mori Vendimin nr. 68 datë 28.04.2021, duke vendosur pezullimin e shpërndarjes së fitimit të shoqërive të sigurimit për vitin 2020.

Totali i aktiveve të tregut të sigurimeve arriti në rreth 41 miliardë lekë, dhe në raport me PBB-në rezultoi të jetë 2.15 % në 31.12.2021. Rreth 87% e totalit të aktiveve zotërohen nga shoqëritë e tregut të Jo-Jetës dhe 13% i përkasin shoqërive të tregut të Jetës.

Në 31.12.2021 investimet të cilat rezultojnë me vlerë 27.8 miliardë lekë kanë vijuar të dominojnë totalin e aktiveve të tregut të sigurimeve, duke zënë rreth 68% të totalit të tyre. Rritja e investimeve krahasuar me vitin paraardhës është 2.5 miliardë lekë ose 10% më shumë krahasuar me një vit më parë.

Të ardhurat bruto në tregun e sigurimeve gjatë vitit 2021 u rritën me 16% krahasuar me një vit më parë, dëmet e paguara bruto u ulën me 11% duke arritur në 6.7 miliardë lekë, përfshirë dhe dëmet objekt Fond Kompensimi, në krahasim me vitin 2020. Ulja e konsiderueshme e dëmeve të paguara bruto në vitin 2021 vjen kryesisht nga portofoli i zjarrit dhe rreziqe shtesë, si rezultat i pagesave gjatë vitit 2020, të dëmeve të shkaktuara nga dy tërmetet e vitit 2019.

## II. Report on the Financial Position of the Insurance Market

### 1. Insurance market structure

During 2021, 12 Life and Non-Life insurance companies operated in the insurance market. In the market structure, eight and four insurance companies operate in the Non-Life and Life market respectively. One of the Non-Life insurance companies is also licensed to carry out reinsurance activities. Following the same trend as in previous years, based on the technical account statement of Non-Life insurance companies, even during 2021 it is noted that the insurance market continues to be dominated by compulsory insurance products, especially the internal MTPL portfolio.

### 2. Insurance market supervision


Overall, although in a difficult year due to the effects of the pandemic, the insurance market appeared stable in terms of key financial health indicators, resisting the effects of the pandemic, with good indicators of liquidity, solvency as well as coverage with technical provisions.

Due to the duration of the Covid-19 pandemic, in order to maintain the insurance companies liquidity level and financial indicators, AFSA's Board took Decision No. 68 dated 28.04.2021, establishing the suspension of the distribution of the insurance companies profit for 2020.

The total assets of the insurance market amounted to about ALL 41 billion, and in relation to GDP it turned out to be 2.15% on 31.12.2021. About 87% of the total assets are owned by Non-Life market companies and 13% belong to Life Market companies.

On 31.12.2021, investments amounting to ALL 27.8 billion have continued to dominate the total insurance market assets, accounting for about 68% of the total. The increase of investments compared to the previous year is ALL 2.5 billion or 10% more compared to a year ago.

Gross income in the insurance market during 2021 increased by 16% compared to the previous year. Gross claims paid decreased by 11% reaching ALL 6.7 billion, including claims subject to the Compensation Fund, compared to 2020. The significant decrease in gross claims paid in 2021 is mainly from the fire and additional risks portfolio, as a result of payments during 2020, of damages caused by the two earthquakes of 2019.



Në strukturë, tregu vijoi të mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat zënë rreth 93% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto në këtë treg. Ndërsa sigurimet e Jetës, zënë 7% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto. Gjatë vitit 2021, sigurimet vullnetare përbëjnë 38%, ndërsa ato të detyrueshme 62% të totalit të primeve të shkruara bruto.

AMF, si autoritet mbikëqyrës e rregullator për tregun e sigurimeve ka si objektiv, ndër të tjera, nxitjen dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të këtij tregu. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet avancimit drejt mbikëqyrjes së plotë me bazë rrezikut, forcimit të rregullave të administrimit të rrezikut dhe në harmoni me direktivat përkatëse të BE-së e bazën ligjore në fuqi.

Gjatë vitit 2021 u krye një inspektim i plotë i planifikuar tek shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës sipas metodologjisë me fokus rrezikun, bazuar në Manualin e Mbikëqyrjes së Shoqërive të Sigurimit. Inspektimi u përqendrua në vlerësimin e rreziqeve kryesore ndaj të cilave ekspozohen shoqëritë e sigurimit sipas aktiviteteve të biznesit, si dhe administrimi dhe zbutja e këtyre rreziqeve nga drejtimi i lartë i shoqërisë. Inspektimi sipas metodologjisë me fokus rrezikun përqendrohet edhe në përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë së sigurimit në drejtim të ruajtjes së stabilitetit financiar të saj.

Gjatë vitit 2021, janë kryer 5 inspektive tematike pranë shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës. Objekti i këtyre inspektiveve tematike ishte shqyrtimi i procesit të marrjes në sigurim për kontratat e lidhura me përgjegjësinë e ndërtuesit, në zbatim të elementëve dhe kushteve të përgjithshme të miratuara nga Autoriteti, konkretisht: verifikimi i përputhshmërisë së elementëve dhe kushteve të përgjithshme të kontratave të lëshuara gjatë periudhës objekt inspektimi, me bazën ligjore në fuqi; procedurat e brendshme të marrjes në sigurim dhe përgjegjësitë e kontraktuara nga shoqëria; mbulimi me risigurim për kontratat e sigurimit të lidhura me përgjegjësinë e ndërtuesit.

Në përfundim të këtyre inspektiveve, Autoriteti u komunikoi shoqërive gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, si dhe adresoi me Vendime Bordi problematikat e konstatuara dhe masat e nevojshme për t'u ndërmarrë nga shoqëritë e sigurimeve. Zbatueshmëria e rekomandimeve është në vëmendje të Autoritetit si për respektimin e afateve dhe detyrave të lëna.

Në kuadër të bashkëpunimit në vijimësi me Bankën e Shqipërisë, AMF gjatë vitit 2021 ka kryer 2 inspektive të përbashkëta pranë bankave tregtare. Këto inspektive synojnë verifikimin e aktivitetit të shoqërive të sigurimit nëpërmjet sistemit bankar. Objekt i këtyre inspektiveve

*With regard to the structure, the market continued to be oriented towards Non-Life insurance, which accounts for 93% of the total volume of gross written premiums in this market. Whereas Life insurance occupy 7% of the total volume of gross written premiums. During 2021, voluntary insurance occupied 38% and the compulsory insurance 62% of the total gross written premiums.*

*AFSA, as the supervisory and regulatory authority for the insurance market, has among its objective, the promotion and maintenance of the financial stability of this market. This is intended to be achieved through the advancement towards full risk-based supervision, strengthening of risk management rules and in line with the relevant EU directives and the applicable laws.*

*During 2021, a full planned inspection of Non-Life insurance companies was carried out according to the risk-based methodology, based on the Supervision Manual of Insurance Companies. Inspection focused on assessing the main risks which insurance companies are exposed to inherent in their business activities, as well as on the management and mitigation of these risks the senior management of the company. The risk-based inspection methodology also focuses on the Supervisory Board's and senior management's responsibilities of the insurance companies, in view of maintaining their financial stability.*

*During 2021, 5 thematic inspections were conducted at Non-Life insurance companies. These thematic inspections aimed to review of the underwriting process for the contracts related to the builders' liability, in implementation of the general elements and terms approved by AFSA, specifically: verification of the compatibility of the general elements and terms of the contracts issued during the inspection period, with the legal basis in force; internal underwriting procedures and responsibilities contracted by the company; reinsurance coverage for insurance contracts related to builder's liability.*

*At the end of these inspections, AFSA informed the companies regarding the relevant findings and recommendations, as well as addressed the identified problems and the necessary measures to be taken by the insurance companies through Board Decisions. The viability of recommendations is the focus of AFSA, in terms of compliance with the deadlines and the assigned tasks.*

*In the framework of the ongoing cooperation with the Bank of Albania, during 2021 AFSA has carried out 2 joint inspections at commercial banks. These inspections aim to verify the activity of insurance companies through the banking system. These*

ishte verifikimi i kontratave që shoqëritë e sigurimit lëshojnë për palë të treta, verifikimi i vlerave monetare të shoqërive të sigurimit, llogaritë bankare dhe depozitat qëllimore dhe me afat, si dhe verifikimi i asetëve të shoqërive të sigurimit pranë këtyre bankave. Gjithashtu, në këto inspekte Autoriteti u fokusua dhe në verifikimin e marrëveshjeve të shoqërive të sigurimit me bankat, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit në drejtim të transparencës në procesin e marrjes në sigurim.

Risigurimi është një mjet i rëndësishëm i menaxhimit të riskut për shoqëritë e sigurimit. Ky aktivitet ka qenë në fokus të Autoritetit gjatë viteve të fundit, si pasojë edhe e ngjarjeve të tërmetit gjatë vitit 2019 si dhe pandemisë COVID-19. Përveç raportimeve periodike mujore dhe tremujore, me ndodhjen e ngjarjeve të tërmetit në vitin 2019, Autoriteti ka monitoruar raportimet javore mbi ecurinë e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e sigurimit në klasat e Jo-Jetës si dhe ka kërkuar informacion. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, në nivel drejtues, janë kryer takime me përfaqësuesit e shoqërive të sigurimit ku është diskutuar në lidhje me procesin e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, mbajtjen maksimale për shoqëri sigurimi si dhe mbulimin maksimal nga risiguruesit.

Vlerësimet e kërkesave për dëmshpërblim të kryera deri në fund të vitit 2021 për dy ngjarjet rezultojnë rreth 4.6 miliardë lekë në vlerë dhe 6329 në numër. Nga këto praktika, dëmet e paguara rezultojnë në nivelin 95% në numër dhe 87% në vlerë. Përsa i përket frekuencës së dëmeve, ajo rezulton në nivelin 13.5% ndërsa dëmi mesatar i raportuar rezulton rreth 720 mijë lekë. Për këto ngjarje, në periudhën e konsideruar, rezultojnë më pak se një për dymijë dëme në proces gjyqësor. Në bazë të marrëveshjeve të risigurimit rezultojnë që këto ngjarje do të mbulohen rreth 8% nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin në klasat e Jo-Jetës dhe 92% nga risiguruesit, të klasifikuara A dhe lart, sipas agjencive klasifikuese Standard & Poors, AM Best, Fitch, etj., duke qenë në zbatim të Rregullores nr. 85/1, datë 30.09.2015 «Për kriteret e risigurimit», e ndryshuar. Ekspozimi i shoqërive të sigurimit ndaj riskut të tërmetit është në përputhje me Rregulloren nr. 57, datë 26.05.2017 «Mbi llogaritjen e Mbajtjes Neto të Mbulimit Maksimal Agregat të rreziqeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit».

Përsa i përket riskut të lidhur me COVID-19, Autoriteti ka monitoruar risqet e nënshkruara, kalimin në risigurim si dhe trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim. Nga raportimet e shoqërive të sigurimit për 31.12.2021, rezultojnë 98 raste humbje jete, prej të cilave janë paguar 95 praktika në vlerë totale 160,208,567 lekë dhe mbeten ende pezull 3 praktika me vlerën 606,411 lekë. Në bazë të


*inspections aimed to verify the contracts that the insurance companies issue to third parties, to verify the monetary values of the insurance companies, bank accounts and one-purpose and term deposits, as well as to verify the assets of the insurance companies at these banks. Furthermore, during these inspections, AFSA focused on verifying the agreements of insurance companies with banks, with a view to protect consumers in terms of transparency in the underwriting process.*

*Reinsurance is an important risk management tool for insurance companies. This activity has been the focus of AFSA in recent years, as a result of the earthquake events in 2019, as well as the COVID-19 pandemic. In addition to periodic monthly and quarterly reports, after the earthquake events in 2019, AFSA has monitored weekly reports on the progress of compensation claims handling by companies that carry out insurance activity in the Non-Life classes and has requested information. Additionally, during this period, in the management level, meetings were held with representatives of insurance companies, where discussions were held on the process of compensation claims handling, the maximum retention for insurance companies, as well as maximum coverage by reinsurers.*

*Estimates of the compensation claims conducted at the end of 2021 for the two events amount to about ALL 4.6 billion in value and 6329 in number. From these practices, the claims paid result in 95% in number and 87% in value. In terms of claims frequency, it results in the level of 13.5% while the average reported claim is found to be about ALL 720 thousand. For these events, in the concerned period, it results less than one in two thousand claims undergoing legal proceedings. Based on the reinsurance agreements, it turns out that 8% of these events will be covered by the companies operating in the Non-Life classes and 92% by the reinsurers, class A and above, according to the rating agencies Standard & Poor's, AM Best, Fitch and others, in compliance with Regulation No. 85/1, dated 30.09.2015, "On reinsurance criteria", as amended. The exposure of insurance companies to earthquake risk is in accordance with Regulation No. 57, dated 26.05.2017 "On the calculation of the Net Retention of the Maximum Aggregate Coverage of risks derived from insurance contracts".*

*Regarding the risk related to COVID-19, AFSA has monitored the signed risks, the transfer to reinsurance as well as the claims' handling for compensation. From the reports of the insurance companies for 31.12.2021, there are 98 cases of lives lost, of which 95 practices have been paid in total value of ALL 160,208,567 and 3 practices with the value of ALL 606,411 are still*





marrëveshjeve të risigurimit, për këtë ngjarje, vetëm 27% e vlerës së kërkesave për dëmshpërblim janë paguar nga risiguresit.

Për ngjarjet e COVID-19 dhe tërmetit, procesi i marrjes në sigurim, trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim, cedimi në risigurim si dhe retrocedimi, gjykohe në nivel të kënaqshëm nga Autoriteti pasi shoqëritë e sigurimit rezultuan të mirëprovigjonuara, duke përmbushur detyrimet e tyre për pagesën e dëmeve.

Viti 2021 shënoi zhvillime të rëndësishme sa i përket kuadrin ligjor e rregullator në fushën e sigurimeve. Në datën 16.03.2021, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm motorik në sektorin e transportit”, i cili hyri në fuqi në datën 01.07.2021. Në kuadër të plotësimit të mëtejshëm të bazës rregullatore, Autoriteti ka miratuar edhe një sërë rregulloresh, në zbatim të kërkesave të këtij ligji.

Në vitin 2021, janë kryer takime virtuale midis Autoritetit dhe kolegjeve mbikëqyrëse të grupeve të sigurimeve Uniqa Insurance Group dhe Vienna Insurance Group. Këto kolegje janë në funksion të mbikëqyrjes efektive të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në lidhje me ecurinë e aktivitetit të tyre. Pjesë e raportimit ishin rreziqet që karakterizojnë funksionimin e tyre në tregun shqiptar të sigurimit, si dhe sjelljen në vëmendje të çështjeve dhe problematikave të konstatuara nga mbikëqyrja.

Në zbatim edhe të Strategjisë së Autoritetit 2018–2022, përfaqësues të tij dhe Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) zhvilluan edhe gjatë vitit 2021 kolegjin mbikëqyrës për një grup sigurimesh me kapital vendas që ushtron aktivitet edhe në Republikën e Kosovës, në bazë të Udhëzimit Metodologjik “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”. Qëllimi i këtij kolegji është shkëmbimi i informacionit në funksion të mbikëqyrjes efektive në nivel grupi për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit, të cilat kanë investime apo degë të tyre në vende të huaja. Çështjet kryesore të trajtuara në këtë kolegji kanë qenë ndër të tjera vlefshmëria reciproke e policave të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, detyrimet reciproke mbi praktikën e dëmeve apo trajtimin dhe pagesën e dëmeve, ndikimi i pandemisë Covid-19 në treguesit financiarë të shoqërive të grupit, etj.

*pending. Based on the reinsurance agreements, for this event, only 27% of the value of the claims were paid by the reinsurers.*

*For the COVID-19 events, the acquisition process, compensation claims handling, reinsurance cession, as well as retro-cession, are evaluated at a satisfactory level by AFSA as the insurance companies were found to be well-provided fulfilling their obligations for claims compensation.*

*The year 2021 marked significant developments in terms of legal and regulatory activity in the field of insurance. On 16.03.2021, the Albanian Parliament approved Law No. 32/2021 “On compulsory insurance in the transport sector”, which entered into force on July 1st, 2021. In the framework of the further completion of the regulatory basis, AFSA has also approved a number of regulations, in compliance with the requirements of this law.*

*In 2021, virtual meetings took place between AFSA and the supervisory colleges of the insurance groups such as: “Uniqa Insurance Group” and “Vienna Insurance Group”. The supervisory college’s objective is the effective supervision of insurance and reinsurance companies, through the exchange of information concerning the progress of their activity. Part of the reporting were the risks that characterise their operations in the Albanian market, as well as bringing to their attention the issues and problems noticed during supervision.*

*In compliance with AFSA’s strategy 2018-2022, representatives of AFSA and the Central Bank of Kosovo (CBK) held even during 2021 the supervisory college for an insurance group with local capital operating in the Republic of Kosovo as well, based on the Methodological Guideline “On Insurance groups supervision”. The purpose of this college is the exchange of information in view of an effective supervision at group level for the local insurance and reinsurance companies, which have invested or have their branches in foreign countries. The main issues addressed in this college are, among others, the mutual validity of compulsory motor insurance policies for liabilities toward third parties, mutual liabilities over claims or claims handling and payment, the impact of the Covid-19 pandemic on financial indicators of group companies and others.*

### 3. Analiza e ecurisë të tregut të sigurimeve<sup>1</sup>

Ecuria e treguesve kryesorë financiarë të tregut të sigurimeve për vitin 2021, paraqitet si më poshtë:

- **Totali i primeve të shkruara bruto**, për tregun e sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës në 31.12.2021 është 19.27 miliardë lekë duke shënuar një rritje prej 2.66 miliardë lekë ose 16% krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes së volumit të primeve të shkruara bruto në masën 2.4 miliard lekë ose rreth 16% për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës dhe rritje prej 265 milionë lekë ose rreth 23 % në tregun e sigurimeve të Jetës.
- **Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit** për tregun e Jo-Jetës në 31.12.2021 është i mjaftueshëm, me 3.7 miliardë lekë mbi nivelin e kërkuar, ose 184%. Për tregun e Jetës treguesi është sërish i mjaftueshëm me rreth 556 milionë lekë mbi nivelin e kërkuar, ose 138%. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ka pësuar rritje për të dy tregjet e sigurimeve.
- **Treguesi i Aktiveve në mbulim të Provigjoneve Teknike** për tregun e sigurimeve për vitin 2021 ka pësuar një rënie të lehtë në 129.51%. Për tregun e Jo-Jetës ky tregues ishte 130.13% në fund të vitit 2021, ndërsa për tregun e Jetës 124%.
- **Treguesit e Rentabilitetit ROE (Kthimi nga kapitalet e veta) dhe ROI (Kthimi nga investimi)** për vitin 2021, janë përkatësisht ROE në nivelin 4.6% nga 8.73% në vitin 2020 dhe ROI 0.3% nga 2.68% në vitin 2020.
- **Totali i aktivitetit të tregut të sigurimit** për periudhën 31.12.2021, sipas pasqyrave financiare, është rreth 41 miliardë lekë dhe ka pësuar rritje në vlerën 1.7 miliard lekë krahasuar me 31.12.2020. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së zërit “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare” në të dy sektorët, Jo-Jetës dhe Jetës.
- Në vitin 2021 vihet re një rritje e vlerës së **provigjoneve teknike bruto** në nivel tregu, me 5% ose rreth 1 mld lekë, e ndikuar nga të dy aktivitetet. Për aktivitetin e Jo-Jetës rritja rezultoi të jetë rreth 827 milion lekë ose 4%, ndërsa për shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin në klasat e Jetës rezultoi një


<sup>1</sup>Treguesit financiarë pasqyrojnë të dhënat pas certifikimit të raporteve të audituara dhe analizës financiare të shoqërive të sigurimit.

### 3. Analysis of the insurance market performance<sup>1</sup>

The progress of the 2021 financial indicators of the insurance market is as follows:

- **Total of gross written premiums** for Life and Non-Life insurance market as of 31.12.2021 is ALL 19.27 billion, marking a increase of ALL 2.66 billion or 16% compared to the previous year. This increase is due to the increase of the gross written premiums volume by ALL 2.4 billion or 16% in the Non-Life insurance market and the increase by ALL 265 million or 23% in the Life insurance market.
- **The Capital Adequacy Indicator** for the Non-Life market on 31.12.2021 is sufficient, with ALL 3.7 billion, or 184%, above the required level. For the Life market, the indicator is also sufficient, with about ALL 556 million, or 138%, above the required level. The capital adequacy indicator has increased for both insurance markets.
- **The Indicator of Assets covering Technical Provisions** for the insurance market for 2021 has suffered a slight decrease of about 129.51%. For the Non-Life market this indicator was 130.13% at the end of 2021, while for the Life market 124%.
- **ROE (Return on Equity) and ROI (Return on Investment) Profitability Indicators** for 2021 are as follows: ROE 4.6% from 8.73% in 2020 and ROI 0.3% from 2.68% in 2020.
- **Total assets of the insurance market** for the period of 31.12.2021, according to the financial statements, amount to ALL 41 billion, marking an increase by ALL 1.7 billion compared to 31.12.2020. This increase has come mainly as a result of the increase in the item “Investments in land, buildings and financial investments” in both sectors, Non-Life and Life.
- In 2021, an increase in the value of gross **technical provisions** at the market level is observed, by 5% or about ALL 1 billion, influenced by both activities. For the Non-Life activity, the increase was approximately about ALL 827 million or 4%, while for companies that operate activity

<sup>1</sup> Financial indicators reflect data after the certification of audited reports and the financial analysis of insurance companies.



rritje e provigjoneve teknike bruto me rreth 205 milion lekë ose 10%.

- **Rezultati financiar neto** i tregut të sigurimeve për vitin 2021 është pozitiv në vlerën 601 milionë lekë. Rezultati financiar në fund të vitit 2021 për shoqëritë e sigurimit ka pësuar një rënie me 438 milionë lekë, krahasuar me vitin 2020. Kjo rënie ka ardhur si rezultat i rënies me rreth 411 milionë lekë të tregut të Jo-Jetës, ndërkohë që tregu i Jetës ka rezultuar me rënie të rezultatit financiar në vlerën 27 milionë lekë. Rënia e rezultatit financiar të tregut të Jo-Jetës për vitin 2021 është e ndikuar kryesisht nga aplikimi i politikave kontabël lidhur me zhvlerësimet e asetëve dhe provigjonimet e debitorëve nga aktiviteti i sigurimit. Sa i përket tregut të Jetës, rënia me 27 milionë lekë është ndikuar kryesisht nga rritja e shpenzimeve operative përkundrejt primeve të shkruara bruto, si edhe rritja e pagesës së dëmeve si pasojë e COVID-19.

Edhe gjatë vitit 2021, me qëllim vlerësimin e shëndetit financiar të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, janë përdorur testet e paralajmërimit të hershëm (Early Warning Test). Këta tregues financiarë i shërbejnë evidentimit të problemeve që mund të bëhen shkak për përkeqësimin e një ose disa parametrave të operatorëve në treg. Ruajtja e qëndrueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje dhe mbrojtja e konsumatorit janë ndër objektivat kryesore të veprimtarisë së AMF-së. Veprimet e Autoritetit me qëllim parandalimin dhe eliminimin e shkeljeve në këtë drejtim, përfshijnë monitorimin e praktikave të tregut në mënyrë të vazhdueshme dhe ndërhyrjen me theks të veçantë në ato aktivitete, të cilat janë të ekspozuara ndaj rrezikut të lartë apo që mund të sjellin cenim të interesave të konsumatorëve.

Gjatë vitit 2021, rekomandimet që AMF ka dhënë lidhen kryesisht me:

- Ruajtjen dhe arritjen e aftësisë paguese të disa shoqërive, sipas dispozitave të nenit 80 të Ligjit 52/2014;
- Ruajtjen dhe arritjen e treguesit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, sipas dispozitave të nenit 96 të Ligjit 52/2014;
- Plotësimin e kërkesave të Bordit të AMF-së në lidhje me pasqyrimin e saktë në pasqyrat financiare dhe shlyerjen e detyrimeve që lidhen me dëmet e Fondit të Kompensimit;

in the life classes, the gross technical provisions increased by about ALL 205 million or 10%.

- **The net financial result** of the insurance market for 2021 is positive, amounting to ALL 601 billion. At the end of 2021, the financial result for insurance companies has decreased by ALL 438 million, compared to 2020. This decrease came as a result of the decrease of the Non-Life market amounting to ALL 411 million, while the Life market marked a decrease of the financial result amounting to ALL 27 million. The decrease of the Non-life market financial result for 2021 is mainly influenced by the application of accounting policies related to the devaluation of assets and provisions of debtors from the insurance activity. As for the Life market, the decrease of ALL 27 million was mainly influenced by the increase in operating expenses compared to the gross written premiums, as well as the increase of claims compensation as a result of COVID-19.

Even during 2021, in view of assessing the financial soundness of Non-Life insurance companies, Early Warning Tests have been used. These financial indicators serve to identify issues that may cause the deterioration of one or more parameters of market operators. Maintaining the sustainability of financial markets under supervision and consumer protection are among the main objectives of AFSA's activity. AFSA's actions in view of preventing and eliminating violations in this regard, include: monitoring of market practices on a continuous basis and intervention with particular emphasis on areas exposed to high risk or consumer interests' protection.

During 2021, the recommendations provided by AFSA mainly relate to:

- Attainment and preservation of the solvency of some companies, as provided for in Article 80 of Law 52/2014;
- Attainment and preservation of the assets' indicators, covering technical provisions, as provided for in Article 96 of Law 52/2014;
- Fulfilment of the AFSA Board requirements regarding the accurate reflection in the financial statements and settlement of claims related to the Compensation Fund claims;

- Administrimin e rreziqeve të kontraktuara nga shoqëritë e sigurimit në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi;
  - Vlerësimin dhe trajtimin e dëmeve, si edhe zbatimin e kërkesave ligjore në drejtim të provigjonimit të dëmeve në proces gjyqësor, për një pasqyrim sa më të drejtë të nivelit të rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë;
  - Ndjekjen dhe zbatimin e rregulloreve të miratuara nga Autoriteti lidhur me trajtimin dhe pagesën e dëmeve;
  - Raportimin në Autoritet të informacionit të kërkuar sipas kërkesave ligjore në fuqi; etj.
- *Management of risks contracted by insurance companies in compliance with the applicable legal requirements;*
  - *Evaluation and handling of claims, as well as compliance with the legal requirements for the provision of claims in court proceedings, for a fair reflection of the level of risk contracted by companies;*
  - *Follow-up and implementation of regulations approved by AFSA, regarding claims treatment and payment;*
  - *Reporting to AFSA the required information, in compliance with the applicable legal requirements and others.*

AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi Fondin e Garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij. Fondi i Garancisë është investuar në “depozita qëllimore” në bankat tregtare dhe letra me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

*The AFSA has consistently followed the fulfilment of the legal requirement on the guarantee fund of insurance companies and the implementation of its investment rules. The Guarantee Fund is invested in “special purpose deposits” in commercial banks and securities issued by the Bank of Albania, in compliance with the legal requirements in force.*

### III. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Pensioneve Private Vullnetare

### III. Report on the Financial Position of the Voluntary Private Pension Market

#### 1. Struktura e tregut të Pensioneve Private Vullnetare

#### 1. Voluntary Private Pensions Market Structure

Struktura e tregut të pensioneve private vullnetare për vitin 2021 përbëhet nga katër fonde pensioni, të cilat administrohen nga katër shoqëri të ndryshme administrimi si Raiffeisen Invest sh.a., Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a., Credins Invest sh.a dhe Albsig Invest sh.a.

*The voluntary private pensions market structure for 2021 consists of four pension funds, which are administered by four different management companies such as Raiffeisen Invest sh.a., Sigal-Life Uniqa Group Austria sh.a., Credins Invest sh.a and Albsig Invest sh.a.*

Funksionin e depozitarit për fondet e pensionit e kryejnë First Investment Bank sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a. dhe Tirana Bank sh.a.

*The function of the depository for the pension funds is performed by First Investment Bank sh.a., American Bank of Investments sh.a. and Tirana Bank sh.a.*


#### 2. Mbikëqyrja e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare

#### 2. Voluntary Private Pensions Market Supervision

Mbikëqyrja e tregut të pensioneve private vullnetare ushtrohet nga AMF mbështetur në Ligjin 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, ndryshuar me Ligjin 54/2014, si dhe Ligjin 10197 datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Qëllimi i ligjit për fondet e pensionit vullnetar është të vendosë standardet e nevojshme për:

*The supervision of the voluntary private pensions market is carried out by AFSA pursuant to Law 9572, dated 03.07.2006, “On the Financial Supervisory Authority”, as amended by Law 54/2014, and Law 10197, dated 10.12.2009, “On Voluntary Pension Funds”; as well as its applicable by-laws. The purpose of the Law on Voluntary Pension Funds is to establish the necessary standards for:*

- i. Administrimin me efektivitet të fondeve të pensionit vullnetar, nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e kontributeve të bëra në fondin e pensionit;
- i. *Effective management of voluntary pension funds, through diversification of investments, with the aim of increasing the contributions made to the pension fund;*



- ii. Mbikëqyrjen e biznesit të fondit të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e anëtarit të fondit të pensionit;
- iii. Nxitjen e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe mirëqeverisjes së asetëve të fondit të pensionit;
- iv. Licencimin dhe mbikëqyrjen e shoqërisë administruese të fondit të pensionit dhe planit të pensionit profesional, të depozitarit të asetëve të fondeve të pensionit dhe të gjitha çështjeve të lidhura me to.

- ii. Supervision of the voluntary pension fund business with defined contributions in order to ensure the protection of the pension fund member;
- iii. Promotion of sustainability, security and good governance of the pension fund assets;
- iv. Licensing and supervision of the pension fund management company and the professional pension plan, the depositary of the pension fund assets and all related matters.

Në tregun e fondeve të pensionit vullnetar nuk janë evidentuar problematika të shkaktuara nga situata COVID-19. Gjatë vitit 2021 edhe në kushtet e pandemisë së COVID-19, anëtarët e skemave të pensioneve vullnetare kanë vazhduar të derdhin kontribute në fondet e pensionit. Monitorimi i këtij tregu është kryer duke marrë të dhëna nëpërmjet komunikimeve të vazhdueshme me shoqëritë administruese dhe raporteve periodike të depozituara në AMF ku është vëzhguar ecuria e treguesve të veçantë të këtij tregu. Sa i përket ecurisë së aktiveve neto dhe çmimit të kuotës, vërehet se gjatë këtij viti këta tregues kanë qenë në rritje.

*In the voluntary pension funds market, no issues were identified as being caused by the COVID-19 situation. During 2021, even in the conditions of the COVID-19 pandemic, members of voluntary pension schemes continued to make contributions to pension funds. This market monitoring was carried out by obtaining data through continuous communications with management companies and periodic reports submitted to AFSA, where the performance of specific indicators of this market was observed. As for the progress of net assets and the price of the quota, it is noted that during this year these indicators have been increasing.*

### 3. Treguesit teknikë e financiarë të Tregut të Fondeve të Pensioneve Vullnetare

### 3. Financial and technical indicators of the Voluntary Pension Fund Market

Tregu i pensioneve shfaqet më modest në krahasim me dy tregjet e tjera. Gjatë vitit 2021, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre katër fonde pensioni. Megjithatë, ky treg ka përjetuar një tendencë në rritje, e shprehur kjo në rritjen e vlerës neto të asetëve dhe numrit të anëtarëve. Në 2021, totali i asetëve neto të fondeve të pensioneve private arriti në 4.58 miliardë lekë me një rritje prej 27.23% dhe numri i anëtarëve arriti në 33,571 me një rritje prej 8.22% në krahasim me fundin e vitit 2020.

*The pension market appears more modest compared to the other two markets. During 2021, four pension funds exercised their activity in the voluntary private pension market. However, this market has experienced an increasing trend, expressed in the increase in net value of assets and the number of members. In 2021, the total net assets of private pension funds reached ALL 4.58 billion with an increase of 27.23% and the number of members reached 33,571 with an increase of 8.22% compared to the end of 2020.*

Në 31.12.2021 investimet e tregut të Fondeve të Pensionit Vullnetar janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Vlera e investimeve të këtij tregu në 31.12.2021 është 4.21 miliardë lekë duke zënë një peshë prej 91.49% ndaj totalit të aktiveve të tregut të fondeve të pensionit. Krahasuar me 31.12.2020 këto investime janë rritur me 21.56%. Gjatë vitit 2021, investimet e tregut të Fondeve të Pensioneve përbëhen nga obligacione thesari të Republikës së Shqipërisë me afat maturimi 5, 7, 10 dhe 15 vjeçar. Në total tregu, investimet në Obligacione të qeverisë së RSH me afat maturimi 10 vjeçar janë ato që zënë peshën më të madhe dhe përbëjnë 71.10% të totalit të investimeve të këtij tregu.

*As of 31.12.2021, the investments of the Voluntary Pension Funds market are in line with the applicable legal basis. The investment value of this market as of 31.12.2021 is ALL 4.21 billion, accounting for a share of 91.49% of the pension funds market total assets. Compared to 31.12.2020, these investments have increased by 21.56%. During 2021, investments in the Pension Funds Market consisted of Treasury Bonds of the Republic of Albania with a maturity term of 5, 7, 10 and 15 years. In total, investments in Government Bonds of the Republic of Albania, with a maturity term of 10 years, are the ones occupying the largest share and accounting for 71.10% of the total investments of this market.*

Shoqëritë administruese të fondeve të pensionit Raiffeisen Invest sh.a, Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a, Credins Invest sh.a dhe Albsig Invest sh.a e publikojnë dhe e përditësojnë vlerën e kuotës së pensionit duke zbatuar bazën ligjore në fuqi.

*The Pension Funds Management Companies Raiffeisen Invest sh.a, Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a, Credins Invest sh.a and Albsig Invest sh.a publish and update the value of the pension shares in compliance with the applicable legal basis.*

#### **IV. Raport mbi Gjendjen Financiare të Tregut të Fondeve të Investimeve**

#### **IV. Report on the Financial Position of the Investment Funds Market**

##### **1. Struktura e tregut të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive**

##### **1. Collective Investment Undertakings Market Structure**

Gjatë vitit 2021 kanë kryer aktivitet fondet e mëposhtme të investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur:

*During 2021, the following open-ended investment funds' with a public offering performed activities:*

- Fondi i investimit Raiffeisen Prestigj, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 180, datë 13.12.2011;
- Fondi i investimit Raiffeisen Invest Euro, miratuar me VB të AMF-së nr. 135, datë 26.09.2012;
- Fondi i investimit Credins Premium, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 86, datë 30.05.2016;
- Fondi i investimit WVP Top Invest, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 14, datë 31.01.2018;
- Fondi i investimit Raiffeisen Vizion, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 143, datë 30.07.2018;
- Fondi i investimit Albsig Standard, miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr.255, datë 30.12.2019;
- Fondi i investimit Raiffeisen MiKS miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 153, datë 23.10.2020;
- Fondi i investimit WVP Global miratuar me Vendimin e Bordit të AMF-së Nr.155, datë 23.10.2020;
- Fondi i investimit ABI EIA miratuar me Vendimin e Bordit të AMF Nr. 203, datë 29.12.2020;
- Fondi i investimit ABI Flex Euro miratuar me Vendimin e Bordit të AMF nr.110, datë 30.06.2021;
- Fondi i investimit ABI Flex USD miratuar me Vendimin e Bordit të AMF nr.112, datë 30.06.2021.

- *Raiffeisen Prestigj Investment Fund, approved by AFSA Board Decision No. 180, dated 13.12.2011;*
- *Raiffeisen Invest Euro Investment Fund approved by AFSA Board Decision No. 135, dated 26.09.2012;*
- *Credins Premium Investment Fund approved by AFSA Board Decision No. 86, dated 30.05.2016;*
- *WVP Top Invest Investment Fund, approved by AFSA Board Decision No. 14, dated 31.01.2018;*
- *Raiffeisen Vision Investment Fund, approved by AFSA Board Decision No. 143, dated 30.07.2018;*
- *Albsig Standard Investment Fund, approved by AFSA Board Decision No. 255, dated 30.12.2019;*
- *Raiffeisen Mix Investment Fund, approved by AFSA Board Decision No. 153, dated 23.10.2020;*
- *WVP Global investment fund approved by AFSA Board Decision No. 155, dated 23.10.2020;*
- *ABI EIA investment fund approved by AFSA Board Decision No. 203, dated 29.12.2020;*
- *ABI Flex Euro investment fund approved by AFSA Board Decision No. 110, dated 30.06.2021;*
- *ABI Flex USD investment fund approved by AFSA Board Decision No. 112, dated 30.06.2021.*

Gjatë vitit 2021 kanë kryer aktivitet fondet e mëposhtme të investimit alternative:

*During 2021, the following investment funds have been operating:*

